Mbolli kanabis në pyll, arrestohet 27-vjeçari në Mirditë, shpallet në kërkim bashkëpunëtori i tij. E pëson edhe kryeplaku i fshatit

15 Korrik, 2024 10:00

Madhësia e tekstit:

Mirditë/Vijojnë kontrollet intensive të territorit dhe hetimet proaktive, në kuadër të planit operacional kombëtar të koduar "Territor i Pastër".

Pas një hetimi proaktiv disajavor, finalizohet operacioni policor i koduar "Seven".

Asgjësohen 374 bimë kanabis sativa si dhe sekuestrohen dy armë gjahu.

Vihet në pranga autori i dyshuar, i cili u kap në flagrancë duke u kujdesur për bimët narkotike.

Identifikohet dhe vijon puna intensive për kapjen e bashkëautorit të kësaj veprimtarie kriminale

Procedohen penalisht kryeplaku i fshatit Batra, për shpërdorim detyre.

Në zbatim të masave të përcaktuara në planin operacional kombëtar "Territor i Pastër", për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e tentativave për kultivimin e bimëve narkotike, Shërbimet e Komisariatit të Policisë Mirditë kanë intensifikuar kontrollet në terren dhe hetimet proaktive të bazuara edhe në inteligjencën policore.

Në këtë kuadër, si rezultat i një hetimi disajavor në bashkëpunim me Prokurorinë Lezhë, shërbimet e Komisariatit të Policisë Mirditë në bashkëpunim me Seksionin për Mbështetjen Operacionale të Hetimit në DVP Lezhë, finalizuan me sukses operacionin e koduar "Seven".

Si rezultat i këtij operacioni u arrestua në flagrancë shtetasi:

" E. Ç., 27 vjeç, banues në fshatin Batra, njësia administrative Fan, bashkia Mirditë, i dyshuar për veprën penale "Kultivimi i bimëve narkotike", e kryer në bashkëpunim.

Ky shtetas dyshohet se në hapësirën e pyllit në afërsi të fshatit të tij në vendin e quajtur "Përoi Batrajve", kishte kultivuar në 7 parcela të ndryshme në distancë nga njëra tjetra, 374 bimë kanabis sattiva.

Gjatë operacionit, ky shtetas u kap në flagrancë në njërën nga parcelat duke u kujdesur për bimët narkotike në orët e vona të mbrëmjes.

Gjithashtu pas një pune intensive hetimore, është arritur të identifikohet i dyshuar si bashkëautor në këtë aktivitet kriminal, shtetasi J. M., 33 vjeç, banues në fshatin Xhuxhë, njësia administrative Fan, bashkia Mirditë, i dyshuar për veprën penale "Kultivimi i bimëve narkotike" e kryer në bashkëpunim ku vijon puna për kapjen e tij.

Në vijim të hetimeve procedurale nga policia, gjatë kontrollit të banesës së shtetasit E. Ç., është sekuestruar një armë gjahu çifte pa leje si dhe është bërë bllokimi i po një arme tjetër gjahu me leje.

Në vijim të operacionit, u procedua penalisht për shpërdorim detyre shtetasi S. Gj., me detyrë kryeplak i fshatit Batra. Ky shtetas dyshohen se nuk ka kryer detyrën e tij funksionale, në zonën që mbulon.

Materialet me ngarkim të këtyre shtetasve i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për veprime të mëtejshme.

SONDAZH

Shqipëria ka më shumë apo më pak banorë se sa ka nxjerrë CENS-23?

- Më shumë
- Më pak
- Sa ka nxjerrë CENS-23

Vota

Rezultatet

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

TË NGJASHME

Futbollistë i fundit që ka shënuar gol në çift finale europiani për Çunxiën, Mata: Ky brez është i mrekullueshëm
15 Korrik, 2024

Spanja, Nawas: Të lumtur për finalen, jemi të emocionuar, një ëndërr që duam të bëhet realitet
15 Korrik, 2024

Taboola Feed

Want to know more? click here
amazon.co.uk · Sponsored

If you have a mouse, this game will keep you up all night. No Install. Play for free.
Comfort Siege · Sponsored
Play Now



Search for Online Slots - Spin, Win, Have Fun!
Find the best Slots to play and win online. See the most popular games and start playing today!
Online Slots | Yahoo Search | Sponsored
Search Now

Opt-in to Cyber Safety™
Get Norton 360 to help keep your life online safer with Device Security, a VPN for online privacy and more, all-in-one.
Norton · Sponsored
Learn More

New Small Electric Car For Seniors - The Price May Surprise You
Gobanchan · Sponsored

Search for Online Slots - UK's Top Slots Games
Find the best Slots to play and win online. See the most popular games now!
Online Slots | Yahoo Search | Sponsored
Search Now

Pensioners born before 1963 are now eligible for new hearing aids (Read More)
Hidden Hearing · Sponsored
Learn More

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Vlorë/ Punonjësi i policisë akuzohet kërcënimin, Si paraqitet gjendja e të akuzëmurit
15 Korrik, 2024

Tiranë/ Gjendet pa shenja jete njeri person, dyshohet endacak
15 Korrik, 2024

Pëlcon atak kardiak pasi u fut në Spanin e Komunit, ndërron jetë shtetasja franceze
15 Korrik, 2024

U goditë nga gomonia në Karaburun, 56-vjeçari transportohet me helikopter drejt Tiranës
15 Korrik, 2024

Dhuna ndaj punonjërave të Policisë në Vlorë, Balla: Qytetarët të ankohet pë veprimet e policisë, por kundërshtimi me forcë nuk duhet të tolerohet
15 Korrik, 2024

(FOTO) Kjo është gomonia, helikat e saj ishin goditur pushoman në Karaburun, 56-vjeçari me plagë në kërmiln/ Policia bllokon rajonin, shoqëron drejtuesin
15 Korrik, 2024

KATEGORIA VIDEO

Përfshihet nga flakët një ofan në Fier, rrezikut edhe zonat përreth, zjarrfikësja në vendin e ngjarjes (VIDEO)
15 Korrik, 2024

"Nuk dua dhuratë, dua leje për të festuar në Madrid", Lamine Yamal shprehi dëshirat për dëshilloçja: Futbolli im buron nga rruga
15 Korrik, 2024

Vëllaj: Pishtarë publike të Tiranë janë transformuar si dita me natën, prisnim, hëgjtena dhe siguria e prisha
15 Korrik, 2024

VIDEO/ Baza Ajrore e Gjadrit rikthehet në funksion për fluturimin e helikopterëve "Black Hawk"
15 Korrik, 2024

"Me pak para ndryshojnë jetën e komunitetave", ambasadori Gonzalo për News24: "Dë për Bashkësi", provë suksesi! 10 milionë euro...
15 Korrik, 2024

"Mës Festival", Operuta "Agimi" rikthehet në skenë 70-vjet nga premiera e saj
Fatmira Nikolli | 15 Korrik, 2024

15 Korrik, 2024

© 2024 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.